
NDERMARRJA E SHERBIMEVE KOMUNALE ANALIZA VJETORE E PUNES PER VITIN 2013

Objektivi kryesor i Ndermarrjes Sherbimeve Komunale Durres dhe prioritetet e vendosura per vitin 2013 ka qene rritja e performances se sherbimeve publike ne te cilat kjo ndermarrje operon.

Mbasi analizuam punen e kryer ne cdo sektor me poshte trajtohen arritjet dhe mangesite e verejtura gjate vitit 2013:

- Jane realizuar kenaqshem treguesit ekonomik-financiar.
- Kemi shtrire sherbimin drejt zonave informale te qytetit .
- Kemi zgjidhur ne kohe te gjitha ankesat qe ka pasur komuniteti.
- Kemi plotesuar prioritetet e vena nga analiza e vitit 2013.

Keto objektiva i kemi arritur duke konsoliduar me se miri :

1. Drejtimin operativ te brigadeve dhe sektoreve duke i dhene perparesi evidentimit te problemeve dhe te mangesive te verejtur njekohesisht duke marre masat per ti zgjidhur brenda afateve te percaktuara dhe konform te gjithe rregullave.
2. Nepermjet kontrollit me te mire te shpenzimeve buxhetore per çdo sherbim te kryer.
3. Duke punuar me plan detyre ditore dhe duke zbatuar me korektese Plan-Menaxhimin e sherbimeve dhe disiplinën ne pune.
4. Duke zbatuar te gjitha aktet normative te punedhënesit dhe punemarresit (kontraten kolektive te punes).

A. Pastrimi i Qytetit

1. **Zona A dhe B e Pastrimit ka punuar per te rritur cilesine e pastrimit te qytetit ne teresi gje e cila eshte arrire ne keto procese pune ne nje siperfaqe totale 1.575.930 m²**
 - Jane mirembajtur rruget, trotuaret dhe sheshet gjate dites (turni i I-re dhe II-te) 64 - 66% te siperfaqes ose te shprehura ne siperfaqe çdo dite mirembahen 362.000 m² ne dite turni i pare dhe 270.000 m² turni i II. Kjo e perlloritur sipas diteve te punes te realizuar per kete vite.
 - Jane fshire me fshese turni i III-te ne masen 83% te siperfaqes qe operohet rruget sheshet dhe trotuaret çdo nate nga 82.0 % qe ka qene nje vite me pare ose e shprehur ne siperfaqe sipas diteve te punes çdo nate jane fshire 353.500 m² mesatarisht per çdo nate.
 - Eshte krehur mesatarisht nje siperfaqe prej 120.000 m² ne dite nga 553.000 m² siperfaqe qe jane te inventarizuara dmth çdo 5 dite eshte bere krehja e gjithe siperfaqes. Ndersa gerryerja si nje proces me vete eshte realizuar mesatarisht 29100 m² ne dite ku vemendja eshte perqendruar ne gerryerjen e dherave llumrave, zhavorishteve ne rruget, H.Dushi, D.Tabaku, K.Sotiri, A.Goga , Epikateve, A.Durrsaku , T.Kalaci , A.Naci etj.

- Zeri lagie e rrugëve këte vit është realizuar minimalisht për të vetmin arsye të uljes së shpenzimeve kryesisht në karburant.
- 2. V.M.M.-te ose vendi i mbledhjeve të mbeturinave .Sikurse thame me lart është punuar për të mirëmbajtur VMM-te për këte qëllim janë realizuar.**
- U vendosen 586 rrota kazanëve kryesisht në zonën A të pastrimit .
 - Janë harxhuar 36700 kg gelqere e pashuar për dezinfektimin e VMM-ve.dhe 50 kg klor duke holluar 5 % për të dezinfektuar kazanet dhe mjetet e transportit.
 - Janë lare disa here kazanet dhe vendi i tyre kryesisht në zonën turistike të qytetit.
- 3. Sektori i D.D.D -ve ka bërë dizinfektimin, dizinsektimin dhe deratizimin sipas fazave të zhvillimit të insekteve mushkonjave, dhe luftimin e brejtëseve ose mijëve etj .**

Janë dizinfektuar dhe deratizuar kopshtet dhe çerdhet e qytetit.

- Janë dizinfektuar dhe dizinsektuar disa here sipërfaqet e bregdetit nga kalata Lindore deri Currila, kanali i ujërave të larta në Plazh, kanalet në Njesinë Nr.6, etj.. ndaj mushkonjave dhe mizave. Kjo punë është bërë dhe me mjete të motorizuara .
- Janë dizinfektuar 500 000 m² duke harxhuar këto përpilime me lëndë aktive: - cipemetrinë 55 litra e përdorur kjo në një sipërfaqe 50 Ha. Dhe broidelon 20 kg duke trajtuar një sipërfaqe prej 10 Ha., janë konsumuar deltametrinë 60 litra, cimoklamil 5 kg, mythonil 2 kg .
- Janë deratizuar 9.000 m² sipërfaqe duke shpenzuar 44 kg.klerat.
- Janë dizinfektuar kopshtet (guzhinat) ndaj furrtares me imidaklorgrid 0.5 kg.
- Janë konsumuar 10 kg diflox i cili është përdorur për here të parë në vendet ujembledhëse dhe uje mbajtëse për luftimin e larëveve.
- Realisht për D.D.D. nevojat janë për me shumë sepse dhe vatrat e infeksionit janë me shumë por me mundësi financiare që kemi patur me krah dhe mjete motorrike kemi arritur të mbajmë nën kontroll DDD.
- Në zbatim të Urdhrit nr.64 datë 18.07.2013 të Kryetarit të Bashkisë z.Vangjush Dako për mbikqyrjen dhe mbajtjen nën kontroll të qeneve dhe maceve endacake pa pronarë nga ana jone u hartua një Plan –Punë me detyra konkrete dhe u morën të gjithë masat për të zbatuar këte urdher si rrjedhojë gjatë muajëve korrik, gusht dhe shtator u sterilizuan mbi 220 qen endacake dhe pa pronar duke eliminuar metoden e përdorur me parë me vrasje.

- 4. Evadimi i mbeturinave është realizuar çdo ditë dhe në sezonin e verës dhe 2 here në ditë kryesisht amballazheve kartonave etj. Për këte qëllim kanë punuar 11 – 14 mjete të ndryshme si autoagregate, mjete të hapura ose kamiona dhe triçiklat .**

Për vitin 2013 kemi këto tregues:

- Janë evaduar mbetje urbane 47.334 m³ të ndara këto urbane 47.141 m³ dhe të gjelberta 193 m³.Thëksojmë se volumi është përlogoritur e kompaktuar dmth në raportin 1 me 5 .
- Janë evaduar mbetje dhera dhe inerte që kanë rezultuar nga gërryerja e rrugëve dhe renia e reshjeve një volum prej 1041 m³ gjithëashtu janë evaduar nga pastrimi i bregdetit në zonën currila 380 m³ leshterik pra në total N.SH.K-ja ka evaduar 48.755 m³ ose 29.583 ton.
- Janë përshkuar me ngarkesë për të evaduar mbetjet urbane të pastrimit 7566 rrugë nga 8723 rrugë gjithsejt që janë bërë në vitin 2012 nga mjetet tona dhe 557 rrugë nga 674 rrugë të kryera një vit me parë për evadimin e mbeturinave të gjelbera.

- Mesatarisht çdo dite jane evaduar 130 m³/dite mbetje urbane, 2.85 m³/dite mbeturina dhera inerte etj, ndersa ne dite jane depozituar ne VGM mesatarisht 280 m³.mbeturina gjithfash nga NSHK-ja dhe te tretet.
 - Ne VGM per vitin ne fjale jane depozituar 102.211 m³ mbeturina gjithmone volumi eshte perlloritur i kompaktuar ose 64.377 ton.
5. V.G.M ose vendi i depozitimit te mbeturinave. Ne VGM kryesore eshte prania e nje mjeti te rende Buldozier ose kompaktor gje te cilin “Ne” si ndermarrje kemi lidhur Akt-Marreshje duke marre ne pune buldozierist me mjetet e tyre kjo detyre eshte realizuar ne normalitet por duhet permendur fakti se kjo eshte nje zgjidhje provizore prandaj dhe njehere insistojme qe te blihet nje buldozier nga ana e Bashkise per vitin ne vijim.

Gjate vitit 2013 ne VGM jane depozituar: ne total 102.221 m³ ose 64.377 ton. Volum i cili eshte perlloritur i kompaktuar theksojme se koficienti i kompaktimit eshte marre 1 me 5 qe do te thote se 1 m³ i kompaktuar ose i ngjeshur peshon 625 kg perlloritur kjo peshe sipas VKM nr 175 date 19.01.2011 per qytetin e Durresit .

Te ndara keto :

- Mbetje urbane (Urbane dhe te gjelbera) gjithsej = 96.036 m³ ose 60.021 ton.
- Mbetje dhera, inerte = 1153 m³ ose 1845 ton.
- Mbetje leshterik = 5022 m³ ose 2511 ton.

Pervec N.SH.K-se kane depozituar mbeturina dhe te tretet si :

- N.K.Plazh ne total 22.754 m³ nga te cilat (mbetje urbane 18.000 m³, 112 m³ dhera, 4642 m³ leshterik) te konvertuara ne total 14.335 ton.
- Komuna Golem 6072 m³ mbetje urbane ose 3795 ton.
- Komuna Rashbull – 3560 m³ mbetje urbane ose 2225 ton.
- Autoriteti Portual Durres 3400 m³ mbetje urbane ose 2125 ton
- Fjona 2006 shpk mbetje urbane 564 m³ ose 352 ton.
- Privat te ndryshem 252m³ mbetje urbane ose 157 ton.
- Komuna Katundi i Ri 304 m³ mbetje urbane ose 190 ton .
- Komuna Xhafzotaj 304 m³ mbetje urbane ose 190 ton.
- Bashkia Shijak 2438 m³ mbetje urbane ose 1523 ton.
- Bashkia Kavaje 13808 m³ mbetje urbane ose 8630 ton

Gjithsej te tretet kane evaduar mbetje urbane te kompaktuara 48.702 m³ ose 30.438 ton.

Nga shuma te tretet NK Plazh e cila eshte nen juridiksionin e Bashkise Durres nuk ka detyrim te paguaj sherbimin e kryer ne VGM, pra kosto e ketij sherbimi i cili finanohet nga Bashkia ndersa te gjitha subjektet e tjera qofshin keto Komuna apo Bashki ose subjekte private duhet te financojne per sherbimin ne Fushen e plehereve sipas koston se realizuar dhe nje gje e tille behet e mundur nepermjet Akt-Marreshjes te lidhur ne mes te Bashkise Durres dhe Pushteteve Vendore sikurse u veprua me disa pushtete vendore dhe subjektet per vitin 2012.

Per vitin 2014 Kryetari i Bashkise me urdher nr 149 date 26.12.2013 e ka deleguar lidhjen e akt-marreshjes per te gjitha subjektet komunat dhe Bashkite qe depozitojne mbeturina ne VGM NSHK-se, per te cilen menjehere Drejtoria e Ndermarrjes dhe Sektori i VGM duhet te veprojne per te

zbatuar kete urdher megjithse deri tani ka disa procedura te cilen duhen zgjidhur nga dega ekonomike per marrjen e tarifes per kete qellim.

Mjetet e Inspektoriatit Ndertimit Urbanistik per vitin 2013 ka kryer keto volume pune:

- Fadroma (N.Balla) 205.00 ore pune nga keto (INUK – 38.00 ore, NSHK 225.30 ore dhe N.K.Plazh 0.00 ore dhe 21.30 ore pune jane realizuar per emergjencat civile sipas urdherit Nr. 05/1 prot. Date 03.01.2013 te Drejtorit te NSHK-se ne zbatim te planit te Masave per perballimin e situates te krijuar nga reshjet e diteve te fundit te miratuar nga Kryetari i Bashkise Z. V.Dako si dhe ne zbatim te Urdherit Nr.126 date 21.11.2013 te Kryetarit te Bashkise per pastrimin e nyjes se kullimit tek Ura e Dajlanit.
- Eskavatori me Rrota (L.Qypi) = 568 ore pune nga keto; INUK-128.30 ore, NSHK-366.30 ore dhe N.K.Plazh 3ore pune dhe 70 ore pune per emergjencat civile si fadroma e N.Balles.
- Kamioni (A.Alizoti)= 145 rruge (INUK -8 rruge, NSHK 128 rruge dhe N.K.Plazh 0 rruge.dhe per nevojat e emergjencave jane realizuar 9 rruge. Ketu do te shtojme faktin se Ndermarrja jone i ka perdorur keto mjete per nevojat e punes ne sektore te ndryshme si ne sektoret e pastrimit, V.G.M dhe gjelbrimit .

B- Mirembajtja e Siperfaqeve te Gjelbera dhe Gjelberimi Rrugor

Per mirembajtjen e siperfaqeve te gjelbera ka punuar sektori i gjelberimit sic dihet eshte i organizuar ne 3 Zona gjelbrimi dhe ka arritur keto rezultate:

- Jane ri mbjelle 5600 m2 me bare.
- Jane mbjelle 17700 fidane me lule sezonale nga te cilat 1500 cope lule ishin cilesore te cilat u mbollen ne lulishten e qendres.
- Jane mbjelle 250 fidane oleadra per gjelbrimin e segmentit te rruges Adria poshte ures Dajlanit.
- Jane kryer te gjitha sherbimet agroteknike (prashitje, ujitje, krasitje dhe kositje) te bimesise dekorative duke realizuar keto volume pune :
 - Jane prashitur mesatarisht gjate vitit 2013 te gjithë druret dhe shkurret 6.5 here dmth 48350 cope;
 - Jane prashitur 3.8 here gardhet e gjelbera dmth 14250 m2;
 - Jane pastruar 28600 m2 bordura dhe sheshe e rrugica;
 - eshte fshire 90 % e siperfaqeve me sheshe dhe rrugica qe do te thote mesatarisht cdo dite fshihen 50600 m2;
 - Jane krasitur mesatarisht 1.8 here druret ose 2256 cope dhe shkurret gjate vitit jane krasitur 14100 cope dmth 2.3 here ndaj totalit;
 - Jane formatura gjithsejt 4448 cope shkurret dekorative;
 - Jane krasitur 2.3 here gjate vitit palmat e gjelberimit rrugor;
 - Jane kositur me kose 7.2 here mesatarisht siperfaqe me bare ose 1.29 here me shume se nje vit me pare siperfaqe me bare per te cilen duhet nenvizuar se ne momentin e pikut pranvere ne lulishte te vecanta ka pasur dhe vonesa ne kositje per arsyen se sektori i specializuar i gjelberimit nuk arrin ta perballoje siperfaqen per ta mbajtur gjithmone te kositur si psh.te lulishtja Taulantja dhe Hyrja e Durresit . Ndersa siperfaqet me bare te kultivuar si ne lulishtet e

qendres, Torres , para hyrjes kryesore te portit dhe hyrjes Durrës etj, kositja është kryer me motorrkorse dhe keto sipërfaqe janë mbajtur mire;

- Jane vaditur mesatarisht 5.4 here te gjitha druret e gjelbrimit rrugor dhe 4.4 here sipërfaqet me bare por duhet theksuar se perparësi i është dhene sipërfaqes me bare te lulishtes ne hyrjen e Durrësit e cila u rehabilitua nga Bashkia;

- Eshte punuar per te luftuar ne mynyre mekanike dhe me kimikate semundjet dhe demtonjesit ne druret dhe shkurret dekorative duke e realizuar kete ne 12120 dru e shkurre – jane bere dhe krasitjet dimerore ne 264 dru dhe krasitje pranverore ne 1704 dru.

- Eshte punuar per te mirembajtur dhe stolat duke vendosur derrasa dhe i riparuar mbajtset e tyre.
- Gjithashtu është punuar per shkuljen e cungjeve te palmave fenix te cilat u preken nga hundgjati i kuq i palmave ,jane prere e evaduar drure e dege te thara e te rena ne pyllit park te Koder Vila te cilat jane rezuar e thyer si rezultat i mplakjes dhe i erave . Ne kete pyll park kerkohet nje nderhyrje per ta dendesuar me llojet e pranishme sepse kurordendensia ka rene dhe ka mjaft sipërfaqe te ekspozuara. dhe te zhveshura.
- Demtimet mekanike te bera nga njezë te paidentifikuar si ne thyrjen dhe qerimin e levores kryesisht ne druret e gjelbrimit rrugor është nje problem i vazhdueshem sikurse nuk mund te leme pa permendur dhe ndryshimin e destinacionit te sipërfaqes ne lulishten e pioner – befatrofit dhe hyrja e Durrësit ku sipërfaqe me bare është zëvedesuar me pllaka dhe shtresa me derrasa nga subjekte qe ushtrojne aktivitetin e tyre te sherbimit social.

C. Mirembajtja e Varrezave dhe Sherbimit Funeral

Sektori i mirembajtjes se varrezave ka punuar ne dy brigada. Brigada e pare me drejtim Buxhetor me 14 punonjes te mirembajtjes dhe rojet per njerin objekt te varrezave ka realizuar keto detyra:

- Fshirjen e rrugeve dhe rrugicave ne nje sipërfaqe prej 3200 m² çdo dite por duhet thene deri ne fillim se gjate kontroleve jane konstatuar mjaft te meta.
- Ka mirembajtur bimesine dekorative duke i kryer sherbimet agroteknikeve te 500 drure dhe shkurre decorative.
- Jane kositur dhe grumbulluar mbeturinat mes varreve ne te gjithë sipërfaqen 2-3 here gjate vitit ose 1300 m² ne dite.
 - Jane krasitur 1240 dru e shkurre dekorative.
 - Jane pastruar kanalet kulluese ne 1225 ml.
 - Jane ndertuar 30 ura kalimi per te qytetaret.
 - Jane bere disa riparime te varreve te demtuar si rezultat i renies se pemeve te medha dhe te thara.
- Eshte evidentur se kjo brigade jo gjithmone ka qene rezultative shpesh here është kritikuar per pune jo me rendiment dhe cilesi per te cilen duhet qe per kete vite te rritet kërkesa e llogarise ndaj ketyre punetoreve.Per pune te dobet ndaj punetoreve dhe rojeve jane marre masa ndeshkimore si verejtje dhe çdemtim.

Brigada me drejtim ekonomik sic dihet funksionon brenda NSHK –se me bilanc ne vete dhe per vitin ne fjale ka pasur keto rezultate :

• Jane kryer gjithsej 911 varrime nga keto me Agjensit Private 797 varrime ndersa Agjensia Funerale Shtetere e NSHK ka kryer 114 varrime e zhvarrime, te ndare :

- 68 varrime te rriturish;
- 20 varrime femijesh;
- 4 rivarrime;
- 12 zhvarrime;
- Jane prodhuar ne poligon:
- Hermetik per te rritur 857 komplet;
- Hermetik per femije 27 komplet;
- Ordiner per te rritur 840 komplet;
- Ordiner per femije 18 komplet;
- Jane prodhuar Arkivole te madhesive te ndryshme 56 cope.
- Jane montuar ordiner te rritur 872 komplet dhe 19 komplet ordinere te vegjel.
- Per vitin 2013 jane shitur me fature tatimore keto materiale .
- Jane shitur arkivola 24 cope.
- Jane shitur hermetik te vegjel 24 cope
- Jane shitur hermetik te rritur 872 cope.
- Jane shitur Ordiner te rritur 872 cope .
- Jane shitur Ordiner te vegjel 18 cope.
- Jane shitur Arkivola G1-G2-G3 gjithsejt 83 cope..
- Jane shitur kurora te medha 63 cope.
- Jane shitur kurora te vogla 163 cope.
- Jane shitur kamrik 125 ml.

PRIORITETET E SHERBIMEVE PUBLIKE TE NSHK PER VITIN 2014

Per vitin 2014, stafi drejtues dhe punonjesit e kesaj Ndermarrje do te rrisin performancen e sherbimeve publike duke pasur keto prioritete:

SEKTORI I PASTRIMIT (HIGJENES)

- Te rritet cilesia e sherbimit te pastrimit per secilin operacion pune.
- Te sensibilizohet komuniteti per nje Durres te paster.
- Te shperndahen kontenier te rinj duke shtrire sherbimin drejt periferive te qytetit.
- Ne sezonin turistik veror te lagen rruget 2 here ne dite.
- Te kryhet procesi i dizinfektimit dhe gelqerizimit te VMM-ve.
- Te rritet gadishmeria e mjeteve manuale.

- Te sistemohen çdo dite mbetjet ne VGM.
- Te behen perpjekje per permiresimin teknologjik te fshirjes dhe terheqjes se mbeturinave urbane.

II. SEKTORI I GJELBERIMIT

- Te rritet cilesia e sherbimeve agroteknike ne siperfaqet e gjelberta, kryesisht siperfaqet me bare dhe gjelberimin rrugor. Te behen perpjekje per shtimin e siperfaqeve te gjelberuara ne rruget dhe hapsirat midis blloqeve te banimit, ne bashkepunim me Bashkine.
- Te kryhen me cilesi sherbimet ne druret dekorativ ne rruget e qytetit duke i dhene perparsi mirembajtjes se tyre.
- Te rritet aftesia e vaditjes me rrjet, bot dhe puse.
- Te funksionoje riorganizimi i gjelberimit me punonjes kujdestare per çdo lulishte.

III. SEKTORI FUNERAL

- Te rritet cilesia per mirembajtjen e varrezave publike dhe sherbimin funeral.
- Te rritet cilesia e prodhimeve dhe punimeve ne hermetike dhe ordinere.
- Te rritet performanca e ketij sherbimi publik.